

VENDIM
Nr.1507, datë 19.11.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRJE-
SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.9836 datë 26.11.2007, “Për buxhetin e shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Hyrje-Shkodër.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen tokë/truall 4115 (katër mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) m², me një vlerë totale shpronësimi 88 475 540 (tetëdhjetë e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 88 475 540 (tetëdhjetë e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të fillojë më 20 nëntor 2008 dhe të përfundojë më 30 dhjetor 2008.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS HYRJA QYTET-
VAZHDIM TE KALAJA (SHKODËR) DHE “URA E RE E BUNËS”

Nr.	Pronari			Z.K	Nr.pas	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale/lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Sandër	Pashk	Luani	8591	18/699	Truall	720	21564	15526080	Konfirmuar nga ZRPP
2	Benjamin	Pjerin	Daberdaku	8591	18/112	Truall	1518	21564	32734152	Konfirmuar nga ZRPP
3	Benjamin	Pjerin	Daberdaku	8591	18/698	Truall	862	21564	18588168	Konfirmuar nga ZRPP
4	Benjamin	Pjerin	Daberdaku	8591	18/114	Truall	442	21564	9531288	Konfirmuar nga ZRPP
5	Selami		Bushati	8591	18/107	Truall	246	21564	5304744	Konfirmuar nga ZRPP
6	Antonio Leonard		Matia Matia	8591	18/697	Truall	58	21564	1250712	Konfirmuar nga ZRPP
7	Anjeze		Mjeda	8591	18/696	Truall	12	21564	258768	Konfirmuar nga ZRPP
8	Trashëgimtarë Gjonej			8591	18/121	Truall	135	21564	2911140	Konfirmuar nga ZRPP
9	Trashëgimtarë Daka Tuzi			8591	18/1	Truall	90	21564	1940760	Konfirmuar nga ZRPP
10	Nosh		Gjelaj	8597	14/99	Truall	32	13429	429728	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI					4115		88475540	

